



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.395/21 prot

Datë 09.06.2025

V E N D I M
Nr. 747/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 388/2025, datë 04.03.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “Blerje Shërbim të Printimit”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK përkatësisht me NUIS L22119010H & L01606034A dhe adresë: Njësia Administrative Kashar, Rruga “Ismail Qemali”, ND.40, H. 28, 1050, Yzberisht, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë, me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, KodiPostar 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 388/2025, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “Blerje Shërbim të Printimit”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.12309/1 prot., datë 16.04.2025, me objekt: “Zbatim i vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 388/2025”, protokolluar me tonën nr. 395/13 prot., datë 17.04.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informoi se është zbatuar vendimi i KPP-së nr.388/2025 dhe është kryer procesi i rivlerësimit të SPE. Për këtë arsye autoriteti kontraktor kërkoi lejimin nga ana e KPP-së për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës.

I.3. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.388/2025, datë 20.03.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor nuk kishte zbatuar pikën III.3 të arsyetimit të vendimit nr.388/2025. Për këtë arsye me vendimin nr.538/2025 datë 22.04.2025 vendosi si vijon:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “Blerje Shërbim të Printimit”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.*

2. *Autoriteti kontraktor të kërkojë sqarime nga ankimuesi në përputhje me pikën III.3 të arsyetimit të vendimit nr.388/2025 të KPP-së si dhe të bëjë një analizë të thelluar lidhur me elementët konkretë të marrë përsipër nga secili anëtar i BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK sipas kontratës së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre përsa i takon përqindjes së pjesëmarrjes në këtë bashkëpunimin nga secili anëtar, dhe në raport, me të cilat duhet të përmbushen kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit lidhur me treguesit ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, të cilat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, sikurse specifikohet në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, për të përcaktuar veçanërisht treguesin teknik sa i takon stafit inxhinierik të secilit prej tyre.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën nr.16117/1 prot., datë 03.06.2025, me objekt: “Zbatim i vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 538/2025”, protokolluar me tonën nr. 395/18 prot., datë 04.06.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informoi se është zbatuar vendimi i KPP-së nr.588/2025, sipas të cilit i është dërguar kërkesë për sqarim në SPE në datën 02.05.2025 BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK. BOE ka dërguar sqarimin në përgjigje të kërkesës së sipërcituar brenda afatit të përcaktuar nga AK, në datë 05.05.2025, në bazë të të cilit është kryer procesi i rivlerësimit në SPE. Për këtë arsye autoriteti kontraktor kërkon lejimin nga ana e KPP-së për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës. Bashkëngjitur kësaj shkrese, autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP procesverbalin e vlerësimit me datë 14.05.2025, si dhe shkresën me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për sqarim” të BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.16117/1 prot., datë 03.06.2025, me objekt: “Zbatim i vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 538/2025”, protokolluar me tonën nr. 395/18 prot., datë 04.06.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informoi se është zbatuar vendimi i KPP-së nr.588/2025, sipas të cilit i është dërguar kërkesë për sqarim në SPE në datën 02.05.2025 BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK. BOE ka dërguar sqarimin në përgjigje të kërkesës së sipërcituar brenda afatit të përcaktuar nga AK, në datë 05.05.2025, në bazë të të cilit është kryer procesi i rivlerësimit në SPE. Për këtë arsye autoriteti kontraktor kërkon lejimin nga ana

e KPP-së për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës. Bashkëngjitur kësaj shkrese, autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP procesverbalin e vlerësimit me datë 14.05.2025, si dhe shkresën me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për sqarim” të BOE “Rikon-Al” SHPK & “PC Store” SHPK.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.538/2025, datë 22.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar pikën 2 të dispozitivit të vendimit Nr.538/2025, datë 22.04.2025, si më sipër cituar.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “Blerje Shërbim të Printimit”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

